



Pranuar / Dorezuar Punimje/Pradato Received/Delivered	21. 08 2023	3	viti god year
Organ./Njësia Organ./Judicial Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojcë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMST/IK	5759/2023		118



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.876/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.876/2023 të datës 22.06.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

, kundër masës disiplinore "Vërejtje" me Nr.Ref.192/2023 të datës 02.06.2023 të shqiptuar nga Zëvendësuesi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 21.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.876/2023 e datës 22.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohet masa disiplinore "Vërejtja" me Nr.Ref.192/2023 e datës 02.06.2023 e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ndaj ankuesit.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale dhe regjistri përkatës i nëpunësit civil, masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit _____ i punësuar sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.149/2022 të datës 24.11.2022 në pozitën "Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare" në Departamentin për Organizata Ndërkombëtare, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 02.06.2023 me Nr.Ref.192/2023 Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetimin se: Me datë 02.06.2023 në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë si dhe duke marrë parasysh detyrat dhe përgjegjësitë, pasi që kam shqyrtuar shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë, pasojat e saj, shkallën e fajësisë si dhe kualifikimin e shkeljes, kam konstatuar se z. _____, në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Organizata Ndërkombëtare në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pas përfundimit të mandatit si Ambasador i Republikës së Kosovës në Oslo, Norvegji, ka vazhduar të thirret dhe prezantohet në komunikimet zyrtare si Ambasador, përkundër që i njëjti nuk posedon gradën diplomatike Ambasador. Me nenin 28 (paragrafi 2 dhe 3) të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: Përveç gradës ambasador, gradat jepen nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës, mbi bazën e të dhënave që ndodhen në dosjen personale të çdo punonjësi dhe në bazë të vlerësimeve të bëra, sipas kritereve dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm. 3. Grada diplomatike ambasador miratohet nga Presidenti, me propozimin e Qeverisë" dhe në rastin konkret z. _____ nuk ka pasur dhe nuk ka gradë diplomatike Ambasador por i njëjti ka shërbyer si Ambasador i Republikës së Kosovës në Oslo, Norvegji, pra i njëjti ka pasur funksionin e Ambasadorit vetëm sa ka shërbyer në ARKS, Oslo, Norvegji. Procedura e marrjes së gradës Diplomatie Ambasador, është procedurë e veçantë, ashtu siç përcaktohet me Ligjin Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. z. _____ poashtu me datë 18.03.2023, ka marrë pjesë përmes platformës digjitale në aktivitetet e organizuara të Këshilli Shqiptar në Norvegji (KSHN). Ai i ka adresuar të pranishmit me një fjalë rasti dhe pjesëmarrja e tij, në një vend ku Republika e Kosovës ka përfaqësim dhe atë pa njoftim dhe pa leje paraprake nga MPJD dhe kur njëherit nuk i përket fushëveprimit të angazhimit të tij në MPJD si Drejtori i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare, ka qenë denigruese në raport me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Oslo, Norvegji. Z. _____, pa bazë dhe pa autorizim nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë, ka marrë fjalën në takim. Sa i përket KSHN-së, Ambasada e Republikës së Kosovës, ka pasur udhëzime nga MPJD, që të mos ketë një rol aktiv ose fasilitues në zgjedhjen e kryesisë, por, normalisht kishte udhëzime të vazhdoj me planin për pritjen në ambasadë dhe kishte udhëzime që të përshëndeste organizimin komunitar dhe të ofronte bashkëpunim si mision, por edhe të kërkoj partneritet me organizata/shoqata për të parë se ku dhe si mund të ndihmojë ose të shtojnë vlerë aktiviteteve të ndryshme që ndërliohen me planin/časjen e MPJD-së me diasporën. Me këto, z. _____, duke u prezantuar në komunikimet e tij zyrtare si Ambasador, por edhe pjesëmarrjen e tij në aktivitete pa autorizim dhe leje paraprake, ka vepruar në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar me nenin 25 të Ligjit për Zyrtarë Publik, i cili përcakton se: 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminin, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij

duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike. z. ka vepruar në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar me nenin 26 (paragrafi 1) të Ligjit 06/L144 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: 1. Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit. z. Enira ka vepruar në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar me nenin 28 të Ligjit 06/L144 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij. z. poashtu ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 (paragrafi 1,2,5 dhe 7) të Rregullores (QRK)-Nr.04.2015 për Kodin e mirësjelljes në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: 1. Nëpunësit civil në punën e tyre udhëhiqen nga parimi i pavarësisë profesionale, integritetit personal, përgjegjshmërisë dhe ndershmërisë. 2. Nëpunësit civil duhet t'i kryejnë punët dhe detyrat në mënyrë të drejtë dhe efikase". 5. Nëpunësit civil gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare duhet të krijojnë dhe të ruajnë besimin e organit ku punojnë dhe atyre të cilëve iu shërbejnë. 7. Nëpunësit civil duhet t'i përmbushin detyrat e tyre në mënyrë transparente dhe të atillë që mundëson marrjen e informatave të palëve të interesuara, mundësinë e dialogimit me qytetarët dhe organizatat e interesit si dhe mbikëqyrjen legjitime. Me këto veprime z. ka cenuar institucionin, duke u prezantuar, marrë pjesë në takime dhe realizuar komunikime zyrtare si Ambasador përkundër që grada e tij diplomatike nuk është e tillë. Komunikimet, pjesëmarrja në aktivitete pa autorizim dhe prezantimet si Ambasador të z. i ka realizuar me stafin në MPJD por edhe palët e jashtme. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë më lartë dhe me qëllim të dhënies së mundësisë që z. të reflektojë në raport me kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij dhe duke realizuar komunikime dhe prezantime sipas Akt Emërimit si Drejtor Departamentit.

Ankuesi, kundër masës disiplinore "Vërejtje" me Nr.Ref.192/2023 të datës 02.06.2023, më datë 22.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4875/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Këshilli më datë 12.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga e njëjta me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 07.08.2023 ka nxjerr Vendim VK/2023 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës A.nr.876/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4875/2023 të datës 22.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Dekret nga Presidenti i Republikës së Kosovës për me numër Nr. i Dekretit 209/2019; Shkëlqesia juaj . President i Republikës së Kosovës; Shkresë e datës 27.11.2019; Shkresë e datës 27.11.2019; Vendim me numër Nr.Ref: 77/2022 i datës 21.02.2022; Pëlqimi nga Norvegjia me numër Nr.45/2019 i datës 13.11.2019; Raporti javor i i datës 02.06.2023; E-mail nga për i datës

02.06.2023; E-mail nga për i datës 27.09.2022; E-mail nga për i datës 27.09.2022; E-mail nga për i datës 09.12.2022; Raporti javor i Akademisë Diplomatike dhe prezantimi i Amb. .; E-mail nga për i datës 12.06.2023; E-mail i datës 12.06.2023; Adresimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës me rastin e mbajtjes së shkollës pranverore; E-mail nga për i datës 15.12.2021; web faqja zyrtare e ambasadës së RKS në Paris; E-mail nga për i datës 22.05.2023; E-mail nga për i datës 15.05.2023; Adresim në FB zyrtar i Ministres së MPJD znj. ; Deklaratë e Kryetarit të KSHN-së i datës 06.06.2023; Ftesa dhe komunikimi në Facebook; Vërejtja me numër Nr.Ref.192/2023 02.06.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 876/2023 i datës 12.07.2023; Akt Emërim i me numër AE.Nr.149/2022 24.11.2022; Formulari i përshtimit të punës pa datë; Vërejtja me numër Nr.Ref.09/2023 i datës 23.01.2023; Dekret me numër Nr. i Dekretit 203/2021 i datës 29.12.2021; Vendim me numër Nr.Ref: 19/2022 i datës 20.01.2022; Vendim për sistemim të përhershëm me numër Nr.Ref. 415/2022 i datës 24.11.2022; Dekreti i Presidentit Nr.43/2020 i datës 23.06.2020 i protokolluar me numër 1555-2019/1 datë 23.06.2020; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 43/2020 i datës 23.06.2020; Dekreti i Presidentit Nr.157/2020 i datës 29.10.2020 i protokolluar me numër 1141/1 datë 30.10.2020; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 157/2020 i datës 29.10.2020; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 134/2021 i datës 14.09.2021; Vendim me numër Nr.Ref:338/2021 i datës 14.09.2021; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 192/2019 i datës 19.08.2019; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 182/2019 i datës 08.08.2019; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 133/2021 i datës 08.09.2021; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 157/2021 i datës 05.10.2021; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 183/2019 i datës 08.08.2019; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 217/2019 i datës 18.10.2019; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 285/2019 i datës 31.12.2019; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 156/2021 i datës 05.10.2021; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 178/2019 i datës 08.08.2019; Dekreti me numër Nr.i Dekretit: DED-011/2018 i datës 02.08.2018; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 52/2019 i datës 12.02.2019; Vendim me numër Nr.98/09 i datës 23.11.2009; Dekreti me numër Nr.i Dekretit 148/2021 i datës 21.09.2021; E-mail nga për i datës 31.03.2023; Raporti javor i i datës 31.03.2023; E-mail nga për i datës 20.04.2023; Raporti javor i i datës 20.04.2023; E-mail nga për i datës 19.05.2023; Raporti javor i i datës 19.05.2023; E-mail nga për i datës 02.06.2023; Raporti javor i i datës 02.06.2023; E-mail nga për i datës 28.04.2023; Raporti javor i i datës 28.04.2023; E-mail për i datës 02.06.2023; E-mail nga zyra e sekretarit MPJD për U.E. i datës 01.02.2023; E-mail nga për i datës 30.01.2023; E-mail nga zyra e sekretarit MPJD për etj. i datës 23.11.2022; E-mail nga zyra e sekretarit MPJD për etj. i datës 23.11.2022; E-mail nga zyra e sekretarit MPJD për i datës 31.01.2023; E-mail nga për zyra e sekretarit MPJD i datës 31.01.2023; E-mail nga zyra e sekretarit MPJD për zyra e sekretarit MPJD i datës 31.01.2023; E-mail nga zyra e sekretarit MPJD për zyra e sekretarit MPJD i datës 30.01.2023; E-mail nga për i datës 26.05.2023; E-mail nga për i datës 26.05.2023; E-mail nga për i datës 26.05.2023; E-mail nga për i datës 23.05.2023; E-mail nga për B.I. i datës 22.05.2023; E-mail nga për i datës 05.05.2023; E-mail nga për i datës 05.05.2023; E-mail nga për Burimet Njerëzore MPJD i datës 05.05.2023; E-mail nga për etj. i datës 24.04.2023; E-mail nga për Burimet Njerëzore MPJD i datës 20.04.2023; E-mail nga për i datës 01.03.2023; E-mail nga për i datës 01.03.2023; E-mail nga për i datës 10.07.2023; E-mail nga për i datës



07.07.2023; E-mail nga	për	i datës 20.03.2023; E-mail nga	për	i datës
19.03.2023; E-mail nga	për	etj. i datës 18.03.2023; E-mail nga	për	etj. i datës
17.03.2023; E-mail nga	për	i datës 04.08.2023; E-mail nga	për	i datës
04.08.2023; E-mail nga	për	i datës 18.08.2023; E-mail nga	për	i datës
18.08.2023; E-mail nga	për	i datës 20.08.2023;		

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht provave të administruara, konstaton se ankesa e ankuesit [] është e bazuar, sepse:

Fillimisht ankuesi sipas Dekretit me numër Nr. i dekretit 209/2019 të datës 11.10.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës, ka qenë i emëruar Shef i Misionit/Ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë me seli në Oslo. Ndërsa sipas Dekretit me numër Nr. i dekretit 203/2021 të datës 29.12.2021, të Presidentes së Republikës së Kosovës, ankuesi është tërhequr nga pozita e Shefit të Misionit/Ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë me seli në Oslo. Me datë 20.01.2022 Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka nxjerr vendim me të cilin ka zbatuar Dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovës Nr.203 të datës 29.12.2021 dhe ka liruar ankuesin nga pozita e Shefit të Misionit/Ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë me seli në Oslo. Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 24.11.2022 me numër Ref. 415/2022 ka nxjerr vendim për sistemim të përhershëm të ankuesit [] i cili sipas pikës një (1) të vendimit është sistemuar në pozitën "Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare" në kuadër të Departamentit për Organizata Ndërkombëtare. Ndërsa të njëjtit i është lëshuar Akt Emërimi me numër AE.Nr.149/2022 i datës 24.11.2022 ku mbanë pozitën e punës "Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare" në kuadër të Departamentit për Organizata Ndërkombëtare.

Ndaj ankuesit Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenin 46 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.2, nenin 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 50 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3, nenin 8 paragrafi 1, 2 dhe 4, nenin 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, paragrafi 2 dhe 4, paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Ankuesi [] me datë 07.03.2023 ka pranuar ftesën që të marrë pjesë në takimin e planifikuar të datës 18.03.2023 në Oslo të Norvegjisë, në cilësi private dhe si ish Ambasador duke mos përfaqësuar asnjë institucion. Të njëjtit ftesa i është dërguar nga Këshilli Shqiptar në Norvegji në rrjetin social Facebook ku i njëjti është informuar se mbledhja mbahet me datë 18.03.2023 prej orës 16:00-19:00 ditë e Shtunë. Lidhur me ftesën për z. [], është njoftuar edhe Ambasadorja aktuale e Republikës së Kosovës dhe një gjë të tillë e ka mirëpritur. I njëjti i ka njoftuar që nuk do të merr pjesë fizikisht në takim duke i njoftuar organizatoret për një vendim të tillë. Ndërsa me datë 14.03.2023 përsëri nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Shqiptar në Norvegji [] ankuesi është njoftuar se mund të merr pjesë edhe përmes platformës online

Zoom duke theksuar faktin se një vendim i tij do ti nderojë pa masë. Ankuesi ka pranuar që të merr pjesë përmes platformës digjitale në aktivitetin e organizuar nga Këshilli Shqiptar në Norvegji, ku të pranishmëve i është adresuar me një fjalë rasti, përshëndetëse.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit lidhur me veprimet e tij të cilat janë potencuar në "Vërejtje" me Nr.Ref.192/2023 të datës 02.06.2023 e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Të njëjtit vërejtja i është dhënë pas më shumë se dy muajve pas marrjes pjesë të ankuesit në aktivitetin e organizuar nga Këshilli Shqiptar në Norvegji të datës 18.03.2023 me pretendimin se i njëjti pas përfundimit të mandatit vazhdon të thirret dhe prezantohet në komunikimet zyrtare si Ambasador përkundër që grada e tij diplomatike nuk është e tillë, dhe se komunikimet dhe pjesëmarrja në aktivitete pa autorizim dhe prezantimet si Ambasador të z. [] që i ka realizuar me stafin e MPJD dhe me palët e jashtme përbejnë shkelje ligjore. Vlen të theksohet fakti se ankuesi në komunikimet e tij zyrtare po ashtu për të cilat i është dhënë vërejtja nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë në këtë rast Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nga i njëjti asnjëherë nuk i është tërhequr vërejtja se i njëjti është duke vepruar në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësit që ka aktualisht si "Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare" në kuadër të Departamentit për Organizata Ndërkombëtare, pas përfundimit të mandatit si Ambasador i Republikës së Kosovës në Oslo Norvegji.

Në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi Raportin javor të datës 31.03.2023, 20.04.2023, 19.05.2023, 28.04.2023 e ka përpiluar me titull Ambasador [] "Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare" të cilin e ka adresuar te eprori i tij Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Të njëjtit-ankuesit Drejtori i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme [] përmes e-mailit të datës 27.09.2022 i është drejtuar me titullin i nderuar Ambasador, Po ashtu Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës [] i është drejtuar përmes e-mailit të datës 19.12.2022 me titullin i nderuar Ambasador [] Gjithashtu në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se edhe zyrtarë tjerë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përdorin në komunikimet e tyre emërtimet të cilat i kanë fituar mbi bazë të pozitive të mbajtura në kuadër të Ministrisë dhe se ndaj të njëjtëve nuk kemi vërejtur bazuar në shkresat e lëndës se ka pasur ndonjë inicim të procedurës disiplinore në lidhje me këtë çështje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nuk ka gjetur ndonjë shkresë bazuar në përgjigjen e marrë nga njësia e burimeve njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me të cilën ankuesit i është tërhequr vërejtja nga ana e institucionit apo mbikëqyrësit të tij të drejtpërdrejtë lidhur me pretendimin se i njëjti në komunikime prezantohet si Ambasador, po ashtu në komunikimet e lartcekura me mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë të argumentuara faktet se i njëjti ka komunikuar me titullin Ambasador [] , "Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare" qoftë në komunikimet elektronike të ndryshme apo në Raportet javore të tij, të cilat janë të cekura më lartë dhe i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë hap përkatësisht ndonjë paralajmërim që të modifikoj emërtimin e

pozitës në këto komunikime deri në momentin e shqiptimit të "Vërejtjes" me Nr.Ref.192/2023 e datës 02.06.2023.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së masës disiplinore të kundërshtuar me ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik duke ju referuar procedurës disiplinore të nëpunësve civilë përkatësisht nenit 45 më të cilin përcaktohet se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", dhe si rrjedhojë ka konstatuar se nëpunësi civil mbanë përgjegjësi disiplinore në rastet kur vërtetohet se i njëjti me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur dispozitat e ligjit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës për pozitën që mbanë, dhe mbi bazën që të jenë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësive disiplinore, rrjedhimisht organet kompetente në zbatim të autoritetit publik me rastin e vendosjes lidhur me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të nëpunësve civil janë të obliguar që të veprojnë në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë, mos diskriminimit, objektivitetit, paanësisë, pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, si dhe parimeve siç janë përcaktuar në nenin 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, por se në rastin konkretë sa i përket objektit të kësaj ankese kemi devijim nga obligimi për të vepruar në harmoni me këto parime ligjore, me faktin se nuk është argumentuar me prova konkrete ndonjë paralajmërim nga eprori se kjo formë e komunikimit ka cenuar ndonjë dispozitë ligjore.

Po ashtu, Kolegji në lidhje me këtë çështje që është objekt i kësaj ankese përkatësisht me rastin e vendimmarrjes mori parasysh edhe dispozitat e nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilat dispozita janë përcaktuar në mënyrë shprehimore shkeljet disiplinore, ku parashihet se: *Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta.... 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar".*

Andaj është obligim ligjorë material që me rastin e trajtimit të zyrtarëve publik në çështje të ndryshme administrative që të veprohet konform Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 7 paragrafi 1 në të cilin parashihet: "Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë", bazuar në këto dispozita shqiptimi i masës disiplinore që është objekt i kësaj ankese bie ndeshë me përmbajtjen e kësaj dispozite e që e



bënë të qëndrueshëm pretendimin ankimor të ankuesit në këtë kuptim të shkeljes së dispozitive materiale.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.876/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.